



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 02.09.2014 ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Miratimi i kalendarit të komisionit për periudhën 1–18 shtator 2014.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin “ERASMUS +”, programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin”.
4. Projektligji “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Silva Caka, Tom Doshi, Mark Frroku dhe Dashamir Peza.

Mungojnë:

Edi Paloka, Kastriot Islami, Oerd Bylykbashi, Pandeli Majko, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Tahir Muhedini, Eduard Halimi dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Erzen Tola – drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit

Ermal Elezi – përfaqësues nga Drejtoria e Integritit dhe Projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit

Armond Halebi - drejtor i Agjencisë së Akreditimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ardita Mele – përfaqësuese e Agjencisë së Akreditimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Suela Mustafaraj – përfaqësuese e Agjencisë së Akreditimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Në rendin e ditës kemi miratimin e kalendarit të komisionit për periudhën 1 shtator-18 shtator 2014; projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “ERASMUS +”, programi i BE-së “Për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin” dhe projektligjin “Për akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, me kalendarin. A ka ndonjë vërejtje apo propozim? Kalendarin është i mbështetur tërësisht në programin dhe në kalendarin e miratuar dje nga seanca plenare. Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “ERASMUS +”, programi i BE-së “Për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin”.

Nga Ministria e Arsimit kanë ardhur dy drejtorë, ai i Drejtorisë së Integritetit dhe Projekteve, zoti Ermal Elezi dhe ai i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, zoti Erzen Tola.

Besoj se zoti Elezi do të bëjë një përmbledhje të shkurtër të projektit, i cili është i njohur. Gjithsesi, bëni një koment të shkurtër fare.

Ermal Elezi – Mirëmëngjesi!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Është programi 7-vjeçar i Bashkimit European në fushat përkatëse, siç e cituat edhe ju, parashikon një fond të buxhetit të vetë Komisionit European prej 14,7 miliardë euro. Shqipëria anëtarësohet në këtë program në vijueshmëri edhe të programeve të mëparshme ku ka marrë pjesë. Rrisitë në këtë program janë shumë të mëdha, pasi krijohen mundësi më të mëdha në mobilitetet dhe në projektet bilaterale ose shumëpalëshe që mund të aplikohen.

Mund të them se duke filluar nga korriku i këtij viti ne patëm rezultatet e para në këtë program, pasi 15 studentë shqiptarë fituan bursat e studimit për dy vjet në ekselencë nëpërmjet programit “ERASMUS +”. Kostoja vjetore e pjesëmarrjes parashikohet të jetë 90 mijë euro. Nëse marrim parasysh vetëm përfitimin e këtyre 15 studentëve me një bursë vjetore përftimi prej

30 mijë për secilin për dy vjet, i thonë që ne targetin e analizës kosto-benefite i kemi të tejkaluara përfitimet.

Bashkëpunimet i kemi edhe në rezultatet e programeve të tjera, që janë “Tempus”, po pjesë e “ERASMUS +”, për të cilën kemi pasur një dyfishim të thithjes së fondeve dhe të projekteve në këtë fushë. Kështu që besoj se performanca në këta 7 vjet do të jetë edhe më e mirë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka pyetje?

Fjalën e ka relatorja.

Silva Caka – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, pa dashur t’i shtoj shumë kësaj që tha përfaqësuesi i ministrisë, dua të them se “ERASMUS +”, është programi më i ri arsimor i BE-së, i cili synon t’u japë një dimension më modern sistemeve arsimore dhe t’i përshtatë ato me dinamikën që ka tregu aktual i punës. Ajo që vlen të theksohet nga programi “ERASMUS +”, është se ai do të mbështesë financiarisht projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në luftën kundër trukimit të ndeshjeve, dopingut, dhunës dhe racizmit. Ka edhe projekte të tjera lidhur me rininë, me arsimin etj.

Duke përfunduar, dua të them se në aspektin ligjor dhe procedural është në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit, si edhe në optikën e teknikës legjislativë, besoj se projektligji është në rregull

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Caka!

A ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim.

Kush është dakord?

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 2 “Hyrja në fuqi”. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. A jeni dakord?

Miratohet në tërësi.

Faleminderit! Punë në të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 02.09.2014 ora 10:10

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Silva Caka, Tom Doshi, Mark Frroku dhe Dashamir Peza.

Mungojnë:

Edi Paloka, Kastriot Islami, Oerd Bylykbashi, Pandeli Majko, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Tahir Muhedini, Eduard Halimi dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Armond Halebi - drejtor i Agjencisë së Akreditimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ardita Mele – përfaqësuese e Agjencisë së Akreditimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Suela Mustafaraj – përfaqësuese e Agjencisë së Akreditimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Fatmir Xhafaj - Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, projektligji “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik kanë ardhur, drejtori i Agjencisë së Kreditimit, zoti Armond Halebi, si edhe specialistët e kësaj drejtorie, zonjat Mele dhe Mustafaraj.

Zoti Halebi, ju lutem, bëni një përmbledhje shumë të shkurtër të nismës së ministrisë suaj.

Armond Halebi – Mirëmëngjesi, zoti kryetar!

Shërbimi i Akreditimit në vendin tonë rregullohet dhe kryhet në përputhje me ligjin nr. 9824, datë 01.01.2007 “Për akreditimin në organizmat e vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”. Bazuar në këtë akt ligjor është krijuar dhe funksionon Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit si një institucion buxhetor në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Në këtë akt janë parashikuar baza ligjore dhe parimet ku bazohet akreditimi.

Në nenin 73 të MSA-së theksohet se Shqipëria duhet të marrë të gjitha masat në mënyrë që të arrijë gradualisht përafrimin me rregullat teknike të komunitetit dhe procedurat europiane të vlerësimit të konformitetit të standardizimit, metrologjisë dhe akreditimit.

Dy janë dokumentet europiane që duhet të përafrohen në fushën e akreditimit: rregullorja europiane nr. 765/2008, kërkesa për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut për vendosjen e mallrave në treg dhe standardi **ISO 17011** i vitit 2004, kërkesë e përgjithshme për kompetencën e organizmave akreditues, që akreditojnë organizma të vlerësimit të konformitetit.

Ligji “Për akreditimin në organizmat e vlerësimit të konformitetit” ka përafruar një pjesë të kërkesave të këtyre dokumenteve. Projektligji që sjellim bazohet gjithashtu në rekomandimet e fundit të grupit të vlerësimit të Organizatës Europiane për Akreditim, të cilët kryen një vizitë paravlerësuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit në shkurt të vitit 2010.

Projektligji që po propozojmë është i rëndësishëm, i domosdoshëm dhe në përputhje me kuadrin aktual ligjor europian. Me anë të këtij projektligji dhe akteve të tjera nënligjore, që do të propozojmë më vonë, synohet të realizohet harmonizimi i plotë i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së për fushën e akreditimit.

Projektligji është përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe është në përputhje me formën dhe përmbajtjen e Kushtetutës, si dhe në harmonizim me legjislacionin në fuqi.

Projektligji i propozuar nuk sjell efekte financiare. Përgjegjësi për zbatimin e këtij ligji ka Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Ky ligj përcakton rregulla për krijimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të akreditimit të organizmave të vlerësimit të konformitetit, që kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit. Akreditimi duhet të zbatohet në çdo rast nëse organizmi i vlerësimit të konformitetit kryen aktivitete të vlerësimit të konformitetit në fushën vullnetare apo të detyrueshme, pavarësisht nëse vlerësimi është i detyrueshëm apo vullnetar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka relatori i këtij projektligji, zoti Peza.

Dashamir Peza – Ky ligj i ri zëvendëson atë të vitit 2007 dhe ka si qëllim kryesor përafrimin e legjislacionit tonë me atë të BE-së.

Komisioni i Integritetit do të jetë në gjendje të vlerësojë me mirë se në çfarë mase ky ligj e përafron legjislacionin tonë me atë të BE-së. Në përgjithësi dua të them se projektligji ka për qëllim përcaktimin e rregullave për krijimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të akreditimit të organeve të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete vlerësimi.

Projektligji parashikon organin përgjegjës për akreditimin, që duhet të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si organizmi i vetëm akreditues kombëtar në Republikën e Shqipërisë, i cili do të ofrojë shërbimin e akreditimit për të gjitha organet e vlerësimit si në aspektin e detyrueshëm, ashtu edhe atë vullnetar.

Në projektligj parashikohet që Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të akreditojë laboratorë testues, mjekësorë, kalibruar, organe certifikuese të sistemit të menaxhimit, organe certifikuese të personelit, organe certifikuese të produkteve, organe inspektuese dhe organe që realizojnë teste zotësie në krahasime ndërlaboratorike dhe organe që prodhojnë materiale referuese të certifikuara.

Akreditimi në çdo fushë do të bëhet kundrejt tarifave të akreditimit të paguara nga organi i vlerësimit të konformitetit. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit do të bëjë trajnime për palët e treta kundrejt tarifave përkatëse.

Në aspektin ligjor ky ligj është në përputhje me Kushtetutën dhe me të gjitha kriteret që duhen për të kaluar këtë procedurë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Peza!

Kush ka pyetje?

Zoti Braho, keni fjalën.

Spartak Braho – Çfarë risie ka projektligji i ri në krahasim me ligjin e mëparshëm? Çfarë të reje sjell?

Fatmir Xhafaj – Përfaqësuesja e ministrisë.

Ardita Mele – Unë jam përfaqësuese e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.

Ligji i ri sjell një përputhje të plotë të rregullores europiane në lidhje me akreditimin.

Rregulloja europiane ka dy pjesë: pjesën e akreditimit dhe pjesën e mbikëqyrjes së tregut. Pjesa e mbikëqyrjes së tregut është përafuar me një ligj, që është ligji për mbikëqyrjen e tregut në vitin 2001, ndërsa pjesa për akreditimin po përafrohet me këtë projektligj që kemi propozuar. Në këtë projektligj kemi propozuar akreditimin e laboratorëve mjekësorë, që nuk ka qenë në projektligjin e mëparshëm, pasi pjesa e testimit të laboratorëve mjekësorë nuk quhej si pjesë testimi. Ndërsa në këtë projektligj është propozuar që akreditimi në laboratorët mjekësorë të jetë pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit. Nga ana tjetër, në projektligj janë vendosur edhe kërkesat që duhet të plotësojë një trupë akredituese.

Këto janë dy risitë e këtij projektligji.

Spartak Braho – Këtu parashikohet që certifikatat e lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji mbeten të vlefshme deri në përfundim të rregullt të afatit të përcaktuar në to. Pra, mbeten po ato certifikata që janë dhënë.

Po nëse këto certifikata bien në kundërshtim me ligjin aktual dhe me aktet nënligjore në fuqi, pse duhet të jenë të vlefshme?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ardita Mele – Këto certifikata nuk bien në kundërshtim me ligjin aktual, pasi këto janë lëshuar mbi bazën e standardeve ndërkombëtare dhe nuk kanë lidhje me projektin që po propozohet. Pra, vlefshmëria e tyre mbetet po e njëjtë. Nëse ato janë të vlefshme deri në vitin 2017, atëherë ato do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në vitin 2017.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Meqenëse ligji i mëparshëm po shfuqizohej, menduam të ishte një klauzolë e tillë, në mënyrë që të tregojë se vlefshmëria e këtyre certifikatave nuk ndryshon, pavarësisht se kemi një projektligj të ri.

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Dakord. Kundër dhe abstenime nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 2. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 3. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 4. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 5. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 6. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 7. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 8. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 9.

Po, zoti Peza.

Dashamir Peza – Mendoj se neni 9, do të kërkoj edhe mirëkuptimin e përfaqësuesve të ministrisë, është shumë i gjatë, sepse përfshin edhe funksionet e Drejtorisë së Përgjithshme, por edhe ato të pjesës së bordit.

Fatmir Xhafaj – Ministria e Ekonomisë i ka qejf nenet e gjata. Nuk është hera e parë.

Dashamir Peza – Sugjeroj që çështja, e cila ka të bëjë me krijimin e bordit, të ndahet nga pjesa tjetër dhe të krijohet një nen më vete, pra dy nene që merren me mënyrën e krijimit dhe funksionimit të bordit.

Problemi tjetër lidhet me përbërjen e Bordit të Akreditimit. E para, qoftë nga pikëpamja gramatikore, qoftë nga pikëpamja e logjikës normale, për mendimin tim, pjesa që ka të bëjë me

përbërjen e Bordit të Akreditimit lë për të dëshiruar, sepse këtu thuhet: “Bordi ka 16 anëtarë. Përfaqësimi i tyre është i balancuar dhe me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara. Bordi i Akreditimit përbëhet nga 6 përfaqësues.” Po të shikosh listën e institucioneve që përfshihen, janë më shumë se 6. I bie të futen në një sherr se cila do të fusë anëtar në bord. Mendoj se kjo duhet të formulohet më mirë. Nga pikëpamja e formulimit kjo lë hapësirë për diskutim ose duhet bërë një riformulim qoftë edhe nga pikëpamja gramatikore, që ky nen të jetë pak më i qartë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Armond Halebi – Në draftin që kemi dërguar, kemi caktuar se duhet të jenë dy përfaqësues nga OVK-të (Organet e Vlerësimit të Konformitetit), pastaj është transformuar dhe është bërë “nga Shoqatat Profesionale të Laboratorëve Testues dhe Kalibrues”. Kjo zvogëlon numrin e përfaqësimit të Organeve të Vlerësimit të Konformitetit, që janë edhe trupa certifikues, inspektues, pra fusha është më e gjerë dhe këto janë vendosur për dy laboratorë. Domethënë, të bëhet për përfaqësues nga OVK-të.

Fatmir Xhafaj – Zoti Vasili.

Petrit Vasili – Do të flas edhe një herë tjetër për problemin e bordit. Nga mënyra si është ndërtuar, unë kam një propozim konkret që bordi nga 16 anëtarë, të ketë gjysmën e tij, sepse të gjitha nivelet e përfaqësimit janë të dubluara. Në logjikën e bordeve të tilla, që kanë pikërisht një vlerësim tërësisht teknik dhe jo ndonjë vlerësim të një natyre tjetër, ka një mbingarkesë të jashtëzakonshme në planin institucional dhe në planin e përfaqësimit. Kështu që besoj se me 16 veta është një bord i madh dhe nuk ka kuptim. Konkretisht, ministria përgjegjëse nuk duhet të ketë 6 përfaqësues, sepse edhe 3 janë tepër, Shoqata e Kalibruesve mund të ketë fare mirë një përfaqësues. Të gjitha institucionet mund të kenë nga një përfaqësues. Dublimi është krejtësisht i panevojshëm, sepse edhe mënyra e përzgjedhjes ka shumë paqartësi dhe asnjë prej nesh nuk është i qetë që të thotë se në ç’mënyrë dhe ç’mekanizëm do të jenë këtu, si dhe do të jenë përfaqësues të mirëfilltë të kësaj gjeje.

Për sa i takon Shoqatës së Profesionistëve, duhet të përcaktohet qartë, qoftë edhe me një sqarim të nenit apo ku e di unë, me një dispozitë tjetër shpjeguese se në ç’mënyrë janë këtu, pra përzgjidhen nga ministri, siç i pëlqen atij, apo ka një logjikë të caktuar se si vijnë atje. Në rast se nuk do të jetë ky mekanizëm, atëherë ky bord nuk mund të quhet më i balancuar, por një bord që e ndërtojmë siç na pëlqen. Kështu që mendoj se i gjithë ky nen duhet ripunuar në themel dhe duhet ndërtuar në mënyrë shumë më solide se kaq, sepse ndryshe mund të degradojë misionin e

tij, i gjithë ligji, në rast se kemi një bord, i cili është ndërtuar në mënyrë jo solide, jo të qartë dhe transparente, edhe me gjithë përmbajtjen të përputhur shumë të mirë me ligjin dhe me rregulloren evropiane, një bord që nuk është ndërtuar si duhet, është në gjendje ta degradojë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Vasili!

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 9, pajtohem me shqetësimin e relatorit që ka nevojë të riformulohet, por mendoj se duhet parë edhe vendi, sepse ju këtu flisni për organizimin kombëtar të akreditimit dhe gjatë dispozitës përkatëse i riktheheni Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, të cilën e gjej të rregulluar edhe te neni 6. Gjithashtu, mendoj që këtë nen ta ndani gjatë riformulimit duke nxjerrë qartë bordin, përbërjen, kompetencat, përgjegjësitë dhe mënyrën e përzgjedhjes së tij. Në mënyrën si është organizuar, ka një përzierje të përmbajtjes së nenit 6 me organizmin kombëtar të akreditimit dhe me kompetencat që ka bordi.

Do t'ju lutem që pikën 8 të nenit 9 ta përcaktoni më qartë lidhur me personelin dhe kompetencat që duhet të ketë ai. Besoj se është agjencia më e rëndësishme që funksionon për të përcaktuar rregullat e akreditimit. Them se duhet të ketë personelin më kompetent e më profesional, si dhe disa kriterë që duhet të përmbushë personeli dhe anëtarët e bordit. Gjithashtu, do të ishte e nevojshme të përcaktohej edhe shmangia e parimit të konfliktit të interesit. Bordet janë shumë të rëndësishme dhe përbërja e bordit duhet në çdo rast të shmangë konfliktin e interesit të anëtarëve të bordit.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Faleminderit!

Nuk ka vërejtje të tjera për këtë.

A ka ndonjë koment tjetër nga ministria lidhur me këtë nen, para se ta votojmë?

Armond Halebi – Për sa i takon numrit 6 të anëtarëve, këto janë të përcaktuara lidhur me fushat e detyrueshme, të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e jetës, për këtë arsye janë përzgjedhur ministritë dhe përfaqësimi i tyre në bord.

Për anëtarët e bordit janë të përcaktuar edhe kriteret me rregullore se çfarë kompetence duhet të kenë anëtarët të cilët përfaqësohen në bord.

Fatmir Xhafaj – Zonjë, donit të bënit ndonjë koment shtesë?

Ardita Mele – Ne folëm për akreditimin në fushën e detyrueshme dhe në fushën vullnetare. Pikërisht, përbërja e bordit përfshin si fushën e detyrueshme, ashtu edhe atë

vullnetare. Përbërja me përfaqësues nga ministritë lidhet me fushën e detyrueshme, ku hyjnë shëndeti, siguria në punë, pjesa e ushqimit dhe e mjedisit. Pjesa tjetër, siç janë organet shkencore, Drejtoria e Standardeve, Metrologjia apo nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituar përbëjnë pjesën vullnetare të akreditimit. Ashtu siç tha edhe zoti Halebi, pjesa e kriterëve të përzgjedhjes së anëtarëve do të jetë e përcaktuar në Rregulloren e Bordit të Akreditimit.

Për sa i përket pikës 8 të nenit 9 dhe nenit 6, në nenin 9 jepen në përgjithësi të gjitha kriteret që duhet të plotësojë Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, ndërsa te neni 6 jepen përgjegjësitë që ka kjo drejtori.

Fatmir Xhafaj – A ka komente të tjera? Nuk ka.

Besoj se të gjithë kolegët bien dakord me vërejtjen e relatorit për ta ndarë këtë dispozitë, sepse është shumë e gjatë. Neni me një emërtim, që flet për dy gjëra të ndryshme, shumë mirë mund të ndahet në tri nene: neni i parë, që mund të quhet neni 9 “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit”, të hiqet titulli “Kërkesa për organizmin kombëtar të akreditimit”; neni 9/1, që e ka quajtur relatori, bëhet neni 10 “Ngritja e Bordit të Akreditimit; neni 9/2 bëhet neni 11 “Përbërja e Bordit të Akreditimit”. Këtu jam dakord me vërejtjen e kolegëve, që përfaqësimi me 16 anëtarë nuk ka kuptim. Domethënë, është një numër shumë i madh. Ju keni thënë, me të drejtë, që ka nevojë të ngrihen grupe teknike të cilat asistojnë. Nuk është e thënë që ai të jetë nga Ministria e Ndërtimit, që ju të plotësoni këtu kriteret, sepse ata janë njerëz politikash, nuk janë teknikë të thjeshtë që do të masin apo do të peshojnë dhe thuhet se nuk peshojnë mirë apo nuk masin mirë. Kështu që ky numër duhet zvogëluar, por le ta vendosë komisioni përgjegjës. Ne thjesht do ta çojmë si sugjerim.

A biem dakord të gjithë me ndryshimet e nenit 9? Dakord.

Miratohet.

Nen 10. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Nen 11. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 12. Të gjitha këto ndryshojnë me logjikën që thamë. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Nen 13. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Nen 14. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Nen 15. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Nen 16. Kam dy gjëra te ky nen: e para, 6 muaj për të nxjerrë dy akte nënligjore për Këshillin e Ministrave janë shumë. Ndoshta 3 muaj do të ishte e arsyeshme. I njëjti afat duhet të caktohet edhe për ministrin. A është dakord relatori? Dakord.

A është dakord ministria? Dakord.

Miratohet.

Neni 17. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 18. A jeni dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 19 “Hyrja në fuqi”. Dakord.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. A jeni dakord në tërësi me projektligjin? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi me vërejtjet dhe sugjerimet që do t'i kalojnë Komisionit të Ekonomisë, që është komisioni përgjegjës, në mos gaboje.

Faleminderit!

E mbyllim mbledhjen e sotme. Mbledhja e nesërme do të zhvillohet në orën 10:00 dhe ka në rendin e ditës: projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me relatore zonjën Caka dhe projektligjin “Për të drejtën e informimit”, me relatore zonjën Hysi.

Ditë të mbarë!

